



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 324/17 Prot

Datë 02.02.2026

VENDIM

NR. 16, DATË 29.01.2026

PËR

“ PËR MIRATIMIN PAGËS MINIMALE NË BASHKINË POGRADEC DHE
NDËRMARRJEVE NË VARËSI ”

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil ”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, neni 2, shkronja “c”, Ligjit nr. 10 405, datë 24.03.2011 “ Për kompetencat përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve ” Vendimin e Këshillit të Bashkisë, Nr.128, datë 22.12.2025 “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Poogradec per vitin 2026”, Vkm-së nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi ”,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Paga minimale bruto mujore e punonjësve të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative, Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit dhe Qendrës Arsimore dhe Angjenica e Mbrojtjes së Territorit, të jetë **50 000 (Pesëdhjetë mijë) lekë**.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më datë **01.01.2026**.
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 28, datë 21.03.2023 **shfuqizohet**.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Pogradec, si dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 21 vota

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 29.01.2026

